

Syllabusi i lëndës

Lënda: Hadith III - *Kritika në Hadith*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 303

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2026/2027

Semestri: V

Mësimdhënësi: Prof .ass. dr. Musa Vila

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Kjo lëndë përmban shkaqet që ndikuan në paraqitjen e kritikës në Hadith. Cilët ishin ekspertët e kësaj lëmie si dhe sfidat që patën në filtrimin dhe veçimin e haditheve autentike nga ato apokrifet. Po ashtu përmban etimologjin dhe terminologjin e termave të kësaj shkence të cilët janë shumë specifikë ku përmes tyre bëhet kritika në lidhjen e transmetuesve dhe në tekstin e Hadithit. Pjesa e parë është e përqendruar në kritikën ndaj personave që kanë transmetuar Hadithe, ndërsa pjesa e dytë ka të bëjë me kritikën ndaj tekstit të Hadithit. Po ashtu kemi cekur format mbi trajtimin e tekstit, rregullat dhe shembujt. Gjithashtu përmban një studim që nderlidhet me pershtatshmerin e syneve me realitetin bashkohor dhe qeshtje tjera.

Qëllimi i lëndës:

Qëllimi i kësaj lende është që të ndihmojë studenteve në hulumtimin e thëniesve të traditës profetike, nxjerrja e thëniesve profetike nga librat burimorë ku ata janë të regjistruar, leximi i tyre i drejtë, të kuptuarit e fjalëve të panjohura, nxjerrja e konkluzave dhe vendimeve që kanë të bëjnë me çështje fetare dhe juridike. Të njohurit e studenteve me për se afërmi me metodologjinë e hadithologëve në trajtimin e dy komponentëve kryesorë të hadithit 1. Njohuri mbi analizën e lidhjes së transmetuesve (senedi) do të njihen studentet se si hadithologët i përballuan sfidave të ndryshme dhe arritën që hadithet të filtrojnë nga theniet e shpifura dhe të dobëta po ashtu do të pasojnë rregulla që hollësisht do të njihen studentet me çështjen e lidhjeve të transmetuesve kush konsiderohet transmetues i saktë, i dobët, anonim, dhe kur mund të argumentohet me ta. Po ashtu do të kenë rastin që studentet të njihen me nocionet e akuzës dhe vlerësimit si dhe shkallët e tyre të hadithologët. 2. Njohuri mbi analizën e tekstit të hadithit: kemi cekur metodologjinë shkencore të trajtimit të tekstit të hadithit tek hadithologët duke potencuar format, rregullat dhe shembujt praktik. Gjithashtu studentët do të njihen me

përshtatshmërinë e hadithit me realitetin bashkëkohor. Si ta njohim realitetin e hadithit, çështjet që ndihmojnë në të kuptuar të hadithit në prizmin kohor, vendore, të objektivitetit të shariatit, të aspektit tematik, të aspektit të shkakut, të aspektit semantik, gjuhësor, fetar, dhe konvencional. Studimi i kësaj lende ka për qëllim që studentet të kenë para vetes metodologjinë e hadithologëve dhe eksperteve të hadithit në çështjen e argumentimit me hadithe në pikëpamjet fetare dhe jetësore. Në këtë material studentet do të kenë mundësi që të bëjnë vet një angazhim në klasifikimin dhe filtrimin e haditheve nga thëniet shpifëse dhe të dobëta.

Rezultatet e pritura

Pas përfundimit të këtij kursi student do të jete në gjendje:

1. Te përshkruaj historikun e zhvillimit të hadithit nga koha e Muhamedit a.s deri në etapën e kodifikimit në libra, që me vonë do të jete baze në argumentim.
2. Te krahasoj punën e palodhshme të dijetarëve të hadithit dhe studiuesve të sodit.
3. Te diskutoj formën me të përshtatshme për implementimin e haditheve në jetën praktike.
4. Te mbroj thëniet profetike nga dyshimet dhe akuzat që mund të veshen thënieve të shenjta.
5. Te prezantoj një pasqyre të shkurtër se si praktikisht studiuesi mund të arrijë tek burimi i thënieve profetike në koleksionet e hadithit.
6. Te memorizoj një numër të konsiderueshëm të thepjeve profetike ashtu siç I ka thënë vete Profeti tekstualisht në gjuhën arabe me përkthim në gjuhën shqipe.

Metodologjia e mësimdhënies:

1. Mësimi do të zhvillohet në forme të ligjëratave, ku do të dominojë shpjegimi gojor pa munguar edhe ana praktike.
2. Stimulimi i studenteve në diskutime interaktive, duke përfutur formën me të përshtatshme të argumentimit me thëniet profetike.
3. Do të ketë seminare, punime semestrale ku studentet do të kenë rastin që praktikisht të din të bënë tematika shkencore të mbështetura në argument.
4. Do të ketë shkëmbim të ideve në formën e diskutimit duke pranuar edhe mendimin ndryshe e që do të nxit studentet që të jete me aktiv gjatë ligjëratave.
5. Në aspektin e praktikës mësimdhënësi do të zbret se bashku me studentet në bibliotekën e fakultetit dhe do të njihemi me librat baze të hadithit, të shpjegimit të hadithit, të transmetuesve të hadithit, si dhe metodologjinë shkencore të hadithologëve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë:

1. Shkaqet që ndikuan në paraqitjen e shkencës së kritikës në hadith .

2. Te mbrojturit e transmetimeve nga lëshimet , harresa dhe tolerimet .
3. Te mbrojturit e transmetimeve prej shtimit te fjalëve shpifëse dhe akuzës qe është bere qëllimisht .
4. Analiza e syllabusit qe nga fillimi deri ne përfundim .

Literatura: (Libri : “Kritika shkencore ne hadith” nga faqe 01-23)

Java e dyte:

1. Çka nënkuptohet me akuze dhe vlerësim si dhe definicionet e tyre .
2. Kushtet qe duhen plotësuar për te qene transmetues i hadithit .
3. Metodologjia e Kur;anit dhe sunetit mbi kritiken e transmetimeve.
4. Çka pranohet prej akuzimit dhe vlerësimit tek hadithologet.

Literatura: (Libri: “Kritika shkencore ne hadith” nga faqe 23-46)

Java e trete:

1. Kundërshtimi i shkencës se akuzës dhe shkencës se vlerësimit. 2. Rregullat mbi kundërshtimin e akuzës dhe vlerësimit. 3. Te merret parasysh metoda e dijetareve ne akuzën dhe vlerësimin e tyre. 4. Çdo gjenerate e kritikeve ka nga rangu i tyre rigoroz dhe neutral. 5. Nuk pranohet akuza e cila u behet atyre qe kane fame fetare. 6. Disa transmetues prej te cilëve kane nxjerr hadithe Buhari dhe Muslimi.

Literatura: (Libri: “Kritika shkencore ne hadith” nga faqe 47-63)

Java e katërt:

1. Anonimiteti i transmetuesit. 2. A pranohet transmetimi i personit anonim ne emër, personalitet dhe gjenealogji. 3. Anonimiteti i gjendjes se transmetuesit. 4. Rregulla mbi anonimitetin.

Literatura: (Libri:“Kritika shkencore ne hadith“ nga faqe 70-82)

Java e peste:

1. Potencomi i nocioneve te akuzës dhe vlerësimit. 2. Terminologjia e shprehjeve vlerësuese. 3. Terminologjia e shprehjeve akuzuese.

Literatura: (Libri:”Kritika shkencore ne hadith” nga faqe 83-96)

Java e gjashte:

1. Shkallet e akuzës dhe vlerësimit sipas Imam Dhehebiut. 2. Shkallet e akuzës dhe vlerësimit sipas Iben Haxherit. 3. Vlerësimi dhe akuza si dëshmi ne gjykate.

Literatura: (Libri:”Kritika shkencore ne hadith” nga faqe 97-105)

Java e shtate:

Kollokfiumi i pare.

Java e tete:

1. Metodologjia shkencore mbi trajtimin e tekstit të hadithit. 2. Metodatat që përdoren nga hadithologët në shtjellimin e tekstit. 3. Përkufizimet në tekstin kritik. 4. Zbulimi i teksteve që përmbajnë parregullsi.

Literatura: (Libri: "Kritika shkencore në hadith" nga faqe 106-123)

Java e nëntë:

1. Zbulimi i dobësive të tekstit dhe llojet e dobësive. 2. Teksti i hadithit kundërshton tekstin Kur'anor. 3. Teksti i hadithit kundërshton hadithin autentik. 4. Teksti i hadithit kundërshton një fakt historik apo mendjen e shëndoshë.

Literatura: (Libri: "Kritika shkencore në hadith" nga faqe 124-138)

Java e dhjetë:

1. Përshatshmëria e sunetit me realitetin bashkëkohor. 2. Kuptimi i realitetit bashkëkohor. 3. Çështjet që ndihmojnë në kuptimin e sunetit. 4. Kuptimi i sunetit në prizmin e aspektit semantik, gjuhësor, fetar dhe konvencional.

Literatura: (Libri: "Kritika shkencore në hadith" nga faqe 140-166)

Java e njëmbëdhjetë:

1. Shkaqet e transmetimeve të ndryshme në hadith. 2. Përsëritja e ngjarjes. 3. Transmetimi i hadithit në bazë të kuptimit.

Literatura: (Libri: "Kritika shkencore në hadith" nga faqe 169-175)

Java e dymbëdhjetë:

1. Dallimi i aftësive në memorizim. 2. Transmetimi i hadithit në formë të shkurtuar. 3. Prania e transmetuesit në një pjesë të hadithit. 4. Gabimi i transmetuesit. 5. Gënjeshtra.

Literatura: (Libri: "Kritika shkencore në hadith" nga faqe 176-188)

Java e trembëdhjetë:

1. Rreth akuzës mbi metodologjinë e hadithologëve në vlerësimin e përgjithshëm të sahabëve. 2. Kriteriumi i lartë i sahabëve. 3. Argumente nga Kur'anë dhe syneti që vlerësojnë sahabët. 4. Mohimi i kriteriumit të sahabëve për shkak se disa prej tyre kanë bërë mëkate të mëdha dhe kundërpërgjigja ndaj tyre.

Literatura: (Libri: "Kritika shkencore në hadith" nga faqe 191-222)

Java e katërbëdhjetë:

1. Ndikimi i hadithit në mospajtimet e fukahave. 2. Kur hadithi meriton të vepruhet me të. 3. A kushtëzohet hadithi të jetë i vërtetë për të vepruar me të. 4. Vërtetimi i tekstit të hadithit. 5. Imamët në argumentet e tyre kanë senedet e tyre të veçanta.

Literatura: (Libri: "Kritika shkencore në hadith" nga faqe 227-254)

Java e pesëmbëdhjetë:

1. Harmonizimi i disa haditheve kontroverse. 2. Hadithi mbi pastërtinë e ujit. 3. Vendimi mbi faljen e namazit pas çdo imami. 4. Hadithi që bën krahasimin e besimit me mëkatet e mëdha.

Literatura: (Libri: “Bazat e Hadithit”, faqe 226-234)

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Dr.sci.Musa Vila “Kritika shkencore në hadith” Prishtinë 2004.

1. Dr.sci.Musa Vila “Bazat e hadithit” Prishtinë 2009.

2. Muhamed Kutub “Shkëndijat pejgamberike” Shkup 2002.

3. Ibn El Adevi “Sherhu Ilel el hadith” Xhide 1995.

4. Abdulfetah Ebu Gudhe “Errefu ve Tekmil fi el Xherrhi ve Tadili”, Eleknevi el Hindi Abdulhai”, “Mektebe Ibn Tejmie” 1987

Literatura shtesë:

1. Dr. Welid Ibn Hasen El-Ani, “Menhexh diraset el-esanid eel hukmu alejha”, botimi i I, Jordan, 1997.

2. Muhamed Sabbag, “Et-tesëir el-fenni fil hadith en-nebeëj”, botimi i I, Bejrut, 1998.

3. Dr. Hemmam Abdurrahim Said, “El-Ilelu fil hadith”, botimi i I, Amman, 1980.

4. Abdul Muhsin El-Abbadi, “El-feëaidu el-munteka min Fet’hil Bari ëe kutubi uhra”, botimi i I, Medine, 1990.

5. Dr, Fahredin Ebibi, Hyrje në shkencat e hadithit, Shkup, 2017.

6. Ibnu Salahu, “Ulumul Hadith”, “Darul Fikri”, Siri 1986

7.Sujuti,Abdurrahman,"Tedribu Rravij","Darul Akide",Egjpt 2008

Ngarkesa e studentit			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime	1.6	15	25
Punimi seminarik		10	10
Konsultimi me mësimdhënësin	2	15	30
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual			10
Përgatitja për provimin final			20
Koha e vlerësimit			10
Projektet, prezantimet, etj.	1	15	15
Total			175